# KOMUNIKATË PËR MEDIA

**Anketa e Statistikave të Ujërave (ASU), 2022-2023**

**15.03.2024**

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës së Statistikave të Ujërave (ASU) për vitet 2022 -2023.

## Më shumë të reshura në 2023 sesa në 2022

Të dhënat e ASU 2022-2023 tregojnë se gjithsej numri i ditëve me të reshura në Prishtinë në vitin në vitin 2023 ishte 156 ditë, kurse në vitin 2022 ishte 135 ditë, ose 15,6% me shumë në vitin 2023.

Temperatura mesatare maksimale mujore (në muajin korrik) në vitin 2022 ishte 30.5 ℃, kurse në vitin 2023 ishte 30.1 ℃.

Temperatura mesatare maksimale vjetore në vitin 2022 ishte 18.3 ℃, ndërsa në vitin 2023 ishte 18.9 ℃.
Temperatura mesatare minimale vjetore në vitin 2022 ishte 6.1 ℃, ndërsa në vitin 2023 ishte 6.6 ℃.

Në vitin 2022, rreth 99,83% e popullsisë së Kosovës është furnizuar me ujë nëpërmjet sistemit publik të menaxhuara nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU); ndërsa 0,17% e popullsisë nuk ka pasur qasje në shërbimin e ujësjellësit publik.

**Ekonomitë familjare të kyçura në rrjetin e ujësjellësit publik, 2011-2022 (%)**




### Uji i shfrytëzuar për ujitje në bujqësi

Të dhënat statistikore për ujin e shfrytëzuar për ujitje në bujqësi tregojnë se nga viti në vit ka pasur ndryshime të theksuara të vlerave sasiore. Në vitin 2023, gjithsej sasia e ujit të shpenzuar për ujitje në bujqësi ishte 102.80 mil.m³/vit, ku krahasuar me të dhënat e vitit 2022 kishte një rritje prej 10,2%.

**Uji i shfrytëzuar për ujitje në bujqësi, 2013-2023, mil.m³/vit**

| | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ujitjet në bujqësi me sistem | 54.84 | 58.81 | 56.98 | 62.34 | 54.87 | 53.77 | 52.60 | 55.00 | 56.89 | 44.00 | 46.47 |
| Ujitjet në bujqësi me puse | 12.66 | 11.57 | 16.21 | 17.80 | 15.00 | 16.38 | 18.44 | 27.50 | 20.80 | 49.30 | 56.33 |
| Gjithsej | 67.50 | 70.38 | 73.19 | 80.14 | 69.87 | 70.15 | 71.04 | 82.50 | 77.69 | 93.30 | 102.80 |

Burimi: MBPZHR 2023

Ky publikim ka për qëllim informimin statistikor gjithëpërfshirës të burimeve ujore në Kosovë. Në mënyrë modeste, publikimi synon të kontribuojë në krijimin e një informacioni të qëndrueshëm mbi gjendjen e ujërave në Kosovë.
Rezultatet e prezantuara në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për gjendjen e tanishme të këtij sektori

Për më shumë informata rreth Statistikave të Ujërave (ASU), 2022-2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Environment